



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:126884

Datë: 27.04.2021

Numri i dokumentit: 01738022

**PKR.NR.216/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, me kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj-Rugova me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësorë Dafina Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit T. M. nga fsh.....K....., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe veprë penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.147/20 të dt.05.10.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencë të Prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të akuzuarit T. M. dhe mbrojtësi të tij sipas autorizimit H. M., me dt. 19.04.2021, mori dhe me dt.27.04.2021 e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

T. M. , i biri i Sh. dhe nënës Z. e gjinisë K., i lindur me dt. .... ne fshatin ..... K....., ku dhe banon, i martuar, babe i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën mesme, i pa pune, posedon nr. tele. ...., i gjendjes së dobët ekonomike, nr. personal ....., shqiptar, Shtetas i R. së Kosovës.

**I.ËSHTË FAJTOR**

Për shkak se:

Me dt.06.08.2020, rreth orës 19:30 min, në fshatin .....K....., shtëpinë e tij në kundërshtim me nenin 5 par 1 të Ligjit për Armë Nr.05/L-022, ka mbajtur në pronësi dhe kontroll armë me gaz dhe municion të llojit Walter, calibër 9x9 mm, pa numër serik, prodhim gjerman, në atë mënyrë që me datën e lartcekur, i akuzuari pasi kishte organizuar një aheng familjar në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës gjatë pandemisë i njëjti gjatë ahengut shtie me armë në ajër me çrast pas kontrollit të të njëjtit nga zyrtarët policor , i gjejnë armën për të cilën është konstatuar se nuk posedon leje nga organet kompetente dhe të njëjtën njëherit e konfiskojnë.

-Me çka ka kryer veprë penale, mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 38, 40, 43, 69 neni 70 të KPRK-së, nenit 366 par.1, të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton:

## **DËNIM ME KUSHT**

Të akuzuarit T. M. i cakton dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, mirëpo ky dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale në afat për 1 (një) viti.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet eruo), si dhe shumën 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të viktimave, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të akuzuarit i konfiskohet armë me gaz dhe municion të llojit Walter, calibrë 9x9 mm, pa numër serik, prodhim gjerman, që gjinden në ruajtje sipas rastit policorë 2020-DA-288, të cilat do të shkatërrohen pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **II.REFUZOHET AKTAKUZA**

### **Për shkak se:**

II. Me datë 06.08.2020, rreth orës 19:30 min, në fshatin .....K....., në shtëpinë e tij, ka përdorur armën në kundërshtim me ligji e zbatueshëm lidhur me armët e till , në atë mënyrë që, me datën e lartcekur, i pandehuri pasi kishe organizuar një aheng familjar në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës gjatë pandemisë i njëjti gjatë ahengut shtie disa herë me armë në ajër.

-Me çka kishte për të kryer veprë penale –Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 të KPRK-së.

Prokurorja e shtetit hoqi dorë nga aktakuza sa i përket kësaj veprë penale.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.147/20 të dt.02.10.2020, kundër të akuzuarit T. M. nga fsh .....Komuna ....., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe veprë penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 19.04.2021, Prokurorja e shtetit Valbona Disha - Haxhosaj, para leximit të aktakuzës sa i përket pikës II të aktakuzës për veprë penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-se hoqi dorë meqenëse i pandehuri armën e ka përdorur në aheng familjar dhe qëllimi i tij nuk ishte as të kërcënohej e as të frikësohej askënd, kurse dispozitivi i I të aktakuzës mbetet i pa ndryshuar.

Më pas prokurorja ka vazhduar me leximin e aktakuzës për veprën e penale si në dispozitivin e parë të aktakuzës dhe atë vetëm për veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të

paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së. Pas leximit të aktakuzës dhe njoftimit të akuzuarit me të drejtat e tij, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të drejtat e tij, të njëjti i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Prokurori ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vullnetshëm dhe është në përputhje me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. H. M. po ashtu ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, pasi që është vullnetar dhe ë konsultim me të si mbrojtës.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit pasi që i njëjti i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzë sa i përket pikës I të aktakuzës andaj konform nenit 253 të KPPRK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave.

Gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin duke duke pasur parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Shënimin zyrtar nr.2020-DE-288, të dt. 06.08.2020, Raporti i oficerit I. Xh. i dt. 06.08.2020, Intervista e të pandehurit T. M. në polici me dt.06.08.2020, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i dt.06.08.2020, fotoalbumi i armës së sekuestruar, Deklarata e të akuzuarit T. M. e dhënë në prokurori me 01.10.2020, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Gjykata nuk ka gjetur se ekzistojnë rrethana për përjashtimin e përgjegjësisë penale të akuzuarit, andaj i akuzuari është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 69 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se: i akuzuari e ka pranuar fajësinë, premtori se nuk do të përsëriten veprime të tilla, i përket gjendjes së dobët ekonomike, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, jeton nga të ardhurat që i realizon si veteran. Ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin gjykata nuk gjeti asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se dënimi i përcaktuar me kushte është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprës penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave konform nenit 38 të KPPRK-së.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së u mor vendimi mbi konfiskim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin në paguarjen e paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin që të paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Konform nenit 365 të KPPK-së gjykata ka vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPPRK-së ka vendos si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ashtu që ka refuzuar aktakuzën sa i përket veprës penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 të KPRK-së, pasi që prokurorja ka heq dorë nga aktakuzë për këtë vepër penale në seancën e shqyrtimit fillestarë.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,**

**2020:126884, 27.04.2021**

**Kryetarja e trupit gjykues**

\_\_\_\_\_  
Violeta Husaj Rugova

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2020:126884  
Datë: 27.04.2021  
Numri i dokumentit: 01738022